



Në mbështetje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12. paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 14 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 115 al. 1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154, dhe nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit, 01 nr. 569/1, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 nëntor 2014, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Zonës së veçant të interesit publik dhe bartjen e pronës së paluajtshme

I. Miratohet Propozimi i Kryetarit të komunës 01 nr. 100/2014 të dt. 15. 10. 2014, për shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Xërxë, dhe BARTET e drejta e pronësisë nga PSH e Kosovës dhe KK Rahovec, në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport ngastrat kadastrale që do të ceken në vijim:

- ngastra kadastrale nr. 973-11, në vend të quajtur “Rakita”, sipas kulturës kullosë e kl. 4 në sipërfaqe prej 24068 m², z.k. Xërxë, në emër të KK Rahovecit; ngastra nr. 1015-1, në vend të quajtur “Rakita”, sipas kulturës kullosë e kl. 4, në sipërfaqe prej 28918 m², z.k. Xërxë, në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec dhe ngastra nr 1015-32, në vend të quajtur “Rakita”, sipas kulturës kullosë e kl. 4 në sipërfaqe prej 1180 m², z.k. Xërxë në emër të KK Rahovecit.

II. Obligohet Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë, të angazhojë ekspertin teknik – gjeometrin që të hartojë Skicën e terrenit dhe kopjen e planit për të gjitha ngastrat të cekura në pikën I, të këtij Vendimi, ndërsa të njëjtat në asnjë mënyrë nuk mund të tjetërsohen personave fizik dhe juridik pa pëlqimin paraprak të Kuvendit të komunës së Rahovecit.

III. Pasi që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK Rahovecit, ka siguruar Projektin për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës me objekte përcjellëse në fshatin Xërxë, ndërsa mjetet financiare për këtë qëllim janë siguruar nga buxheti i konsoliduar i komunës së Rahovecit dhe pjesërisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kjo Drejtori ka interes publik që ngastrat të cekura në pikën I, të këtij Vendimi të barten në emër të saj.

IV. Sipas këtij Vendimi, Drejtoria kadastrale komunale e Rahovecit, do të kryej regjistrimin e ndryshmit juridik në Regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

V. Procedurat për zbatimin e këtij Vendimi do t,i udhëheq Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë e KK Rahovecit.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e aprovimit, si dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, i njëjti do të shpallet në ueb faqen zyrtare të komunës.

VII. Me vendim njoftohen: MAPL-ja, Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe arkivi.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 101/2014

Rahovec, më 27.11.2014



Kryesuesi i Kuvendit:
Nahit Elshani